



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
SENATI AKADEMIK

Nr. 3032 / prot.

4

Tiranë, më 19 / 11 / 2021

**VENDIM**

Nr. 81, datë 19.11.2021

**PËR**

**“MIRATIMIN E RREGULLORES SË FUNKSIONIMIT TË KËSHILLIT TË ETIKËS NË  
UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË”**

Në bazë të nenit 3, 36, pika 5, nenit 44 e vijues të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 26, pika 1, germa m), nenit 37 e vijues të Statutit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, Senati Akademik i UMT-së pasi mori në shqyrtim Draft-Rregulloren për funksionimin e Këshillit të Etikës në UMT, e propozuar nga grupi i punës ngritur me Urdhrin e Rektorit nr. 10, datë 15.02.2021 “Për ngritjen e grupit të punës për rishikimin e rregullores së Këshillit të Etikës”,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë Rregulloren për funksionimin e Këshillit të Etikës në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë (bashkëlidhur këtij vendimi).
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi, Këshilli i Etikës në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, Njësitë Kryesore të UMT-së, Administratori i UMT-së si dhe Drejtoritë në Rektoratin e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare (web) të UMT-së.

**KRYETARI  
PROF. ARBEN GJATA**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË

**RREGULLORE E FUNKSIONIMIT TË KËSHILLIT TË ETIKËS**

**UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË**

Miratuar me Vendimin Nr.81, datë 19.11.2021

të Senatit Akademik të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë

**Tiranë, 2021**

A handwritten signature in blue ink, consisting of several loops and a long vertical stroke, located in the bottom right corner of the page.

## **BAZA LIGJORE**

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, ligjin nr. 105/2014 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, ligjin nr. 9181, datë 08.09.2003 “Për rregullat e Etikës në administratën publike”, Statutin dhe Rregulloren e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë si dhe në akte të tjera ligjore e nënligjore, që lidhen me fushën e trajtimit të Këshillit të Etikës, Senati Akademik i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, miraton këtë rregullore:

### **KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

#### **Neni 1 Qëllimi**

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i rregullave të veprimitarisë dhe funksionimit të Këshillit të Etikës së Universitetit të Mjekësisë, Tiranë (këtu e më poshtë KE-UMT), në përputhje me objektivat, misionin ligjor të tij si dhe mënyrën e zbatimit të tyre.

#### **Neni 2 Fusha e zbatimit**

Kjo rregullore i shtrin efektet e saj në të gjithë veprimitarinë dhe funksionimin e Këshillit të Etikës në UMT.

#### **Neni 3 Këshilli i Etikës**

1. Këshilli i Etikës është organ kolegjial në UMT, i cili promovon dhe shqyrton çështje që lidhen me etikën në veprimitarinë e procesit mësimor dhe atij kërkimor si dhe në veprimitaritet të tjera institucionale sipas parashikimeve të Kodit të Etikës, legjislacionit për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor dhe të tjera akte ligjore e nënligjore në Republikën e Shqipërisë.
2. Këshilli i Etikës ka të drejtë të kërkojë dhe të marrë me iniciativë informacione nga personeli akademik, ndihmësakademik me karakter mësimor - shkencor dhe administrativ, nga njësitë përbërëse të UMT-së (përveç Senatit Akademik, Rektorit dhe Bordit të Administrimit) si dhe hallkave paralele dhe Këshillave Studentorë, lidhur me respektimin e kërkesave të moralit dhe etikës, në realizim të funksioneve e detyrave të secilit.



#### **Neni 4**

##### **Përbërja dhe Funkcionet**

Këshilli i Etikës funksionon bazuar në ligjin për arsimin e lartë të Republikës së Shqipërisë, Statutin, Rregulloren e UMT-së si dhe Kodin e Etikës, të miratuar nga Senati Akademik i UMT-së.

Këshilli i Etikës është një organ kolegjal pranë Rektoratit të UMT-së, për problemet e etikës, deontologjisë dhe kërkimit shkencor.

##### ***Përbërja e Këshillit të Etikës***

1. Këshilli i Etikës ka në përbërjen e tij 5 (pesë) anëtarë, personel akademik me kohë të plotë (ku çdo fakultet ka të paktën 1 (një) përfaqësues, të propozuar nga drejtuesi i njësisë kryesore), të cilët i propozohen Rektorit të UMT-së nga drejtuesit e njësive kryesore (dekanët) dhe miratohen nga Senati Akademik.
2. Këshilli i Etikës zgjedh me shumicë votash kryetarin e tij dhe i propozon Senatit Akademik për miratim Kodin e Etikës së UMT-së.
3. Një nga anëtarët e Këshillit të Etikës zgjidhet sekretar.

#### **Neni 5**

##### **Mandati i anëtarëve të Këshillit të Etikës**


1. Mandati i anëtarëve të Këshillit të Etikës së UMT-së është 4 (katër) - vjeçar, me të drejtë rizgjedhje.

#### **Neni 6**

##### **Parime të përgjithshme**

1. Anëtarët e Këshillit të Etikës e kryejnë veprimtarinë e tyre në përputhje me:

- a) parimin e ligjshmërisë;
- b) parimin e barazisë dhe të mosdiskriminimit;
- c) parimin e përgjegjshmërisë;
- ç) parimin e integritetit;
- d) parimin e profesionalizmit dhe kujdesit të duhur;
- dh) parimin e objektivitetit, pavarësisë, sjelljes së paanshme;
- e) parimin e konfidencialitetit;
- f) parimin e eliminimit të konfliktit të interesit.



2. Anëtarët e Këshillit të Etikës duhet të jenë objektiv, të pavarur, të paanshëm, të kujdesshëm në dhënien e mendimeve në mënyrë publike mbi informacionin që zotërojnë, për shkak të funksionit që ushtrojnë.
3. Anëtarët e Këshillit të Etikës duhet të jenë të ndershëm dhe të përkushtuar në kryerjen e detyrës së tyre, duke pasur parasysh vetëm interesin publik të institucionit dhe në përputhje me misionin e Këshillit të Etikës.

#### **Neni 7**

#### **Kryetari i Këshillit të Etikës**

1. Kryetari ose personi i autorizuar prej tij (njëri nga anëtarët ose sekretari i Këshillit të Etikës) thërret Këshillin e Etikës dhe përcakton kohën dhe vendin e mbledhjes. Ai fton Këshillin e Etikës sa herë e kërkon situata.
2. Kryetari hap, drejton dhe mbyll mbledhjet e Këshillit të Etikës. Ai drejton diskutimet, siguron zbatimin e ligjit dhe marrjen e vendimeve të drejta. Në hapje të mbledhjes, Kryetari sigurohet se ka kuorumin e mjaftueshëm për zhvillimin e mbledhjes. Kuorumi quhet i mjaftueshëm nëse janë të pranishëm të paktën 3(tre) anëtarë, që kanë të drejtë vote. Me kërkesë të 1(një) anëtari, Kryetari duhet të përcaktojë sërish kuorumin.
3. Kryetari i Këshillit të Etikës mund të shtyjë ose të mbyllë mbledhjen përpara kohe, në rastet kur situata e përlligj këtë veprim. Në këto raste duhet të merret një vendim i arsyetuar, i cili do të pasqyrohet në procesverbalin e mbledhjes.

#### **Neni 8**

#### **Zëvendësimi i përkohshëm i Kryetarit**

Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe, Kryetari i Këshillit të Etikës zëvendësohet përkohësisht nga anëtari më i madh në moshë, me të drejtë vote.

### **KREU II**

### **TË DREJTAT DHE DETYRIMET E KËSHILLIT TË ETIKËS**

#### **Neni 9**

#### **Të drejtat dhe detyrimet e Këshillit të Etikës për çështje që lidhen me etikën në veprimtarinë e procesit mësimor**

1. Këshilli i Etikës është përgjegjës për zhvillimin e procedurave disiplinore, që janë të parashikuara në Kodin e Etikës, duke përfshirë edhe të drejtën për të organizuar seancë dëgjimore, për secilin person ndaj të cilit është paraqitur një ankesë për shkelje të Kodit të Etikës së UMT-së dhe për të propozuar sanksionet në raste të shkeljeve të Kodit të Etikës.



2. Këshilli i Etikës është përgjegjës për zbatimin e kësaj Rregulloreje, Kodit të Etikës, akteve të tjera të funksionimit të UMT-së si dhe legjislacionit në fuqi.
3. Këshilli i Etikës i paraqet Rektorit konstatimet e tij bashkë me rekomandimet përkatëse, në përputhje me Kodin e Etikës, Statutin dhe Rregulloren e UMT-së, sipas rastit.
4. Këshilli i Etikës shqyrton të gjitha ankesat që paraqiten pranë Zyrës së Protokollit të Rektoratit të UMT-së dhe që i janë deleguar KE-së në zbatim të Kodit të Etikës, si rregull brenda 10 (dhjetë) - ditëve punë nga paraqitja e ankesës/kërkesës.

### **Neni 10**

#### **Të drejtat dhe detyrimet e Këshillit të Etikës për çështje që lidhen me etikën në veprimtarinë kërkimore**

1. Këshilli i Etikës, lidhur me kërkimin shkencor / operacional, siguron mbrojtjen e subjekteve kërkimore. Në veçanti, ai siguron që projekti kërkimor të respektojë dinjitetin, mirëqenien dhe të drejtat e subjekteve. Për këtë qëllim, ai mund të miratojë, të modifikojë, të ndalojë ose të refuzojë çdo propozim ose vazhdim të një projekti, që përfshin subjekte njerëzore, të gjalla ose jo.
2. Këshilli i Etikës siguron që çdo projekt kërkimor të jetë në përputhje me standardet etike të kërkimit shkencor.
3. Për këtë qëllim dhe duke marrë parasysh që bordet shkencore vendosin më parë për vlefshmërinë shkencore dhe rëndësinë e studimit të propozuar, Këshilli i Etikës vlerëson në veçanti elementet e mëposhtme:
  - a) masat e marra për të siguruar respektimin e dinjitetit të subjekteve;
  - b) mënyrën e përzgjedhjes dhe rekrutimit të subjekteve;
  - c) natyrën e rreziqeve shtesë, ndaj të cilave janë të ekspozuar subjektet, si rezultat i aplikimit të protokollit të kërkimit;
  - ç) ekuilibrin midis rreziqeve dhe disavantazheve të studimit për subjektin, përkundrejt përfitimeve që do të rrjedhin prej tij;
  - d) minimizimin e disavantazheve dhe maksimizimin e përfitimit për subjektin;
  - dh) modalitetet e miratimit të lirë dhe të informuar të subjekteve;
  - e) metodën e përdorur për të siguruar respektimin e privatësisë dhe konfidencialitetit të informacionit personal;
  - ë) elementet buxhetore që kanë pasoja etike (në veçanti metoda e shpërblimit të studiuesve dhe ndihmësve të tyre).
  - f) vlerat shkencore. Nëse bëhet fjalë për një projekt kërkimor të tipit të zbatuar, me synim zhvillimin e një ndërhyrjeje më efektive, më pak të rrezikshme dhe të kushtueshme, kërkuesi duhet të tregojë që metodologjia është jo vetëm e vlefshme, por është e përshtatshme dhe mund të japë rezultate klinike të zbatueshme.



4. Gjatë vlerësimit të etikës së një projekti, Këshilli i Etikës do t'i kushtojë vëmendje të veçantë pasojave për pjesëmarrësit, në rastet kur aplikohen metoda të reja apo aplikimin e medikamenteve të reja, si pjesë e një protokollit kërkimor.
5. Këshilli i Etikës është gjithashtu përgjegjës për monitorimin e projekteve kërkimore në zhvillim e sipër, veçanërisht në lidhje me verifikimin dhe/ose miratimin e ndryshimeve, raporteve të efekteve të padëshirueshme, progresit dhe raporteve vjetore.
6. Çdo aprovim ose deklaratë zyrtare e kërkuar nga agjencitë subvencionuese ose porositorët, nënshkruhet nga kryetari i Këshillit të Etikës.
7. Këshilli i Etikës shqyrton çdo projekt kërkimor që paraqet kërkesën për miratim pranë Këshillit të Etikës së UMT-së.
8. Asnjë projekt kërkimor nuk mund të zbatohet nëse nuk miratohet nga Këshilli i Etikës së Kërkimit.

#### **Neni 11**


##### **Përpilimi, mbajtja dhe ruajtja e dosjeve të Këshillit**

1. Këshilli i Etikës përpilon, mban dhe ruan një dosje për çdo projekt të kërkimit, që i paraqitet. Këshilli përditëson çdo dosje në momentin e arkivimit.
2. Dosja përmban dokumentet e përmendura në nenin 12 (të kësaj rregulloreje) në lidhje me projektin.
3. Këshilli garanton konfidencialitetin e dosjeve. Për këtë arsye, vetëm personat e autorizuar kanë akses te dosjet dhe ato (dosjet) ruhen me përgjegjësi në ambientet e Këshillit të Etikës. Të gjitha të dhënat përkatëse do të trajtohen në mënyrë konfidenciale në zyrën e Këshillit të Etikës.
4. Këshilli ruan të gjitha dosjet në ambientet e tij për të paktën 2 (dy) vjet pas përfundimit të studimit. Pas kësaj periudhe, dosjet arkivohen për një periudhë 5 (pesë) - vjeçare, duke filluar nga data e përfundimit të studimit.

#### **Neni 12**

##### **Paraqitja e një projekti kërkimor**

1. Këshilli i Etikës së Kërkimit ka për qëllim të shprehet për projektet kërkimore që u janë paraqitur në një afat prej 6 (gjashtë) - javësh, duke filluar nga dorëzimi i projektit në protokollin e UMT-së. Që të respektohet ky afat është shumë e rëndësishme që projektet të dërgohen sipas kërkesave të përshkruara më poshtë.
2. Dosja e projektit duhet të dorëzohet në sekretarinë e Këshillit të Etikës të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë para mbledhjes së Këshillit. Sekretaria e Këshillit të Etikës gjendet pranë Rektoratit të UMT-së.
3. Dosja e projektit duhet të regjistrohet në zyrën e protokollit të UMT-së.



4. Dosja e projektit duhet të përmbajë:

- formularin e prezantimit të projektit;
- protokollin e detajuar të projektit;
- formularin për dhënien e miratimit;
- letër pranimi nga drejtuesi i projektit;
- aprovimin nga institucioni të cilit i përket studiuesi (nëse është i zbatueshëm);
- aprovimin nga institucioni në të cilin studiuesi do të kryejë studimin e tij (nëse është i zbatueshëm);
- nëse projekti përbën temën e një punimi ose një disertacioni për marrjen e një masteri ose doktorature, aplikuesi duhet të bashkëngjisë një letër nga udhëheqësi i punimit, që tregon pranimin e projektit nga një kërkues shkencor;
- tekstin e plotë me kërkesën për subvencionim (nëse është i zbatueshëm);
- rregulloren për menaxhimin e të dhënave, (nëse është e zbatueshme);
- deklaratën e konfliktit të interesit;
- formularin e miratimit të informuar për pjesëmarrësit në studim
- tarifën për vlerësimin e projektit nga Këshilli i Etikës.

5. Çdo projekt i dorëzuar me dokumente të paplota, do t'i kthehet kërkuesit, i cili ka të drejtë të riaplikojë pas plotësimit të dosjes së projektit.

### **Neni 13**

#### **Raportimi i ngjarjeve negative**

1. Kryetari i Këshillit të Etikës duhet të informohet menjëherë për të gjitha ngjarjet e padëshiruara serioze ose të papritura, që ndodhin gjatë zbatimit të projektit kërkimor dhe që mund të dëmtojnë sigurinë e pjesëmarrësve të studimit ose zbatimin e projektit kërkimor.
2. Kryetari, në konsultim me anëtarët e Këshillit të Etikës, vendos nëse studimi duhet t'i paraqitet Këshillit të Etikës për rivlerësim në takimin e tij të ardhshëm. Në këtë rast, Këshilli i Etikës mund të anulojë vlerësimin e tij pozitiv në tërësi ose pjesërisht, ose të vendosë kushte të tjera.
3. Aplikantit duhet t'i jepet mundësia për të komentuar.

### **Neni 14**

#### **Përgjegjësia e aplikantit/aplikantes**

Pavarësisht nga vlerësimi i Këshillit të Etikës, aplikanti/aplikantja mbetet përgjegjës për veprimet e tij /të saj.





**Neni 15**  
**Miratimi i afatit**

1. Miratimi i afatit të projektit kërkimor bëhet me vendim të Këshillit të Etikës.
2. Afati i miratuar nga Këshillit të Etikës, për projektet kërkimore, si rregull është i vlefshëm për të gjithë periudhën e realizimit të projektit.


**KREU III**  
**THIRRJA E MBLEDHJEVE DHE VOTIMI**

**Neni 16**  
**Thirrja mbledhjeve**

1. Mbledhjet e Këshillit të Etikës, si rregull, thirren nga Kryetari i tij.
2. Thirrja e mbledhjeve mund të bëhet edhe me kërkesë të 1/3 e anëtarëve të Këshillit të Etikës, duke përcaktuar çështjet për të cilat thirret kjo mbledhje.
3. Lajmërimet për thirrjen e mbledhjeve, si rregull bëhen brenda 15 (pesëmbëdhjetë) - ditëve pas paraqitjes së kërkesës nga 1/3 e anëtarëve, të paktën 48 (dyzetetë) orë/ 2 (dy) ditë-para datës së mbajtjes së mbledhjes.
4. Thirrja e mbledhjeve bëhet me shkrim dhe/ose nëpërmjet postës elektronike (e-mail).
5. Njoftimi për mbledhje duhet të përmbajë: ditën, orën, vendin se ku do zhvillohet mbledhja si dhe rendin e ditës sipas çështjeve, të cilat do të diskutohen.
6. Anëtarëve të Këshillit të Etikës, duhet t'i dërgohen të gjitha materialet që do të diskutohen në mbledhje si: relacione, vlerësime, raporte, etj....
7. Këshilli i Etikës si rregull mblidhet jo më pak se 9 mbledhje vit.

**Neni 17**  
**Zhvillimi i mbledhjes**

1. Kryetari i Këshillit të Etikës drejton çdo mbledhje të Këshillit të Etikës.
2. Në rastin kur Kryetari nuk mund të jetë i pranishëm, për çdo lloj arsye (shëndetësore ose të justifikuara) mbledhjen e drejton zv.kryetari (nëse ka të tillë) ose anëtari më i madh në moshë.
3. Sekretari i Këshillit të Etikës në bashkëpunim me Kryetarin e Këshillit të Etikës merret me organizimin dhe koordinimin e punës së Këshillit të Etikës.
4. Kryetari është i detyruar të thërrasë mbledhje atëherë kur:
  - a. është paraqitur ankesë lidhur me çështjet etike dhe kjo i është drejtuar KE-së ose kur nga Rektorati i UMT-së i kalon për trajtim/shqyrtim Këshillit të Etikës;



- b. është paraqitur kërkesë për trajtim/shqyrtim për projektet e kërkimit pranë Këshillit të Etikës;
  - c. mbledhja kërkohet me shkrim nga të paktën 1/3 e anëtarëve, duke përcaktuar çështjet për të cilat thirret kjo mbledhje;
  - d. ka çështje të tjera që kërkojnë diskutim e KE-së;
  - e. në çdo rast kur natyra e çështjes/çështjeve e përligjin këtë veprim.
5. Si rregull, Këshilli i Etikës zhvillon mbledhje në varësi të situatave të përcaktuara në dispozitat e kësaj rregulloreje.
  6. Mbledhjet janë të vlefshme kur janë të pranishëm me shumë se gjysma e anëtarëve të tij.
  7. Mbledhja e Këshillit të Etikës mund të jetë e vlefshme edhe kur nuk respektohen procedurat e parashikuara për thirrjen dhe zhvillimin e saj, vetëm në rast se në atë mbledhje marrin pjesë 3/5 e anëtarëve.
  8. Nëse ndonjë nga anëtarët kërkon përfshirje të një çështjeje të caktuar në rendin e ditës, njofton me shkrim Kryetarin, për ta përfshirë atë.

### **Neni 18** **Rendi i ditës**

1. Çështjet e rendit të ditës, si rregull duhet të lidhen me misionin dhe funksionin që ka KE.
2. Rendi i ditës duhet të përfshijë ato çështje që i janë propozuar atij nga anëtarët e organit kolegjal dhe që janë në kompetencë të këtij organi.
3. Kërkesa për t'u futur një çështje në rendin e ditës duhet të bëhet me shkrim.

### **Neni 19** **Votimi**

1. Vendimet merren me shumicën e anëtarëve të pranishëm, por jo më pak se 3 (tri) vota pro për marrjen e një vendimi.
2. Këshilli mund të shqyrtojë përsëri vendimet e tij nisur nga një kërkesë apo nëse paraqiten fakte apo argumente të reja.
3. Votimet, përgjithësisht, bëhen të hapura.
4. Këshilli i Etikës duhet të përpiqet për një konsensus për vendimin që do të merret. Nëse kjo nuk arrihet, Këshilli i Etikës vendos pas një seance dëgjimore me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm, por jo më pak se 3 (tri) vota pro. Abstenimi konsiderohet refuzim.
5. Si rregull, vendimet për marrjen e masave disiplinore të Këshillit të Etikës merren, duke u bazuar në parimet e normave morale të përgjithshme dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
6. Vendimet, që përmbajnë vlerësime mbi sjelljen ose cilësitë e një individi, të përcaktuara në Kodin e Etikës merren me votim të fshehtë.



**Neni 20**  
**Barazia e votave**

1. Në rastet kur rezultati i votimit është i barabartë dhe votimi është i hapur, vota e Kryetarit është vendimtare.
2. Në rast se votimi bëhet i fshehtë dhe votat janë të barabarta, kryhet një votim i dytë. Kur edhe në votimin e dytë ka barazi të votave, votimi shtyhet për mbledhjen tjetër. Në qoftë se në votimin e parë të mbledhjes tjetër ka përsëri një barazi votash, atëherë kryhet votim i hapur.
3. Vota e Kryetarit është e barazvlefshme me 2 (dy) vota.

**Neni 21**  
**Mënyra e punës së Këshillit të Etikës**

1. Këshilli i Etikës ndërmerr veprime me kërkesë të anëtarëve të tij.
2. Aplikanti mund të ndryshojë ose tërheqë kërkesën e tij.
3. Aplikimi duhet të shoqërohet me një deklaratë nëse, aty ku është e aplikueshme dhe me çfarë rezultati aplikimet me përmbajtje të ngjashme janë paraqitur më parë ose në të njëjtën kohë.
4. Këshilli i Etikës nuk mblidhet në publik. Anëtarët janë të detyruar të ruajnë sekretin dhe konfidencialitetin. E njëjta vlen edhe për ekspertët dhe personat ndihmës, të thirrur për këshilla.
5. Anëtarët e Këshillit të Etikës, të cilët vetë ose të afërmit e tyre, marrin pjesë në një projekt kërkimor për t'u vlerësuar nga Këshilli i Etikës, përjashtohen nga konsultimi dhe vendimmarrja, si shkak i konfliktit të interesit që kanë. Çdokush që është i përfshirë në një projekt kërkimor për t'u këshilluar ose ka të afërm, të cilët janë të përfshirë në të, nuk mund të veprojnë si një ekspert i jashtëm ose person ndihmës në një cilësi këshilluese.
6. Në rastin kur anëtarët e Këshillit të Etikës nuk kanë ekspertizën e nevojshme për të marrë vendim, mund të thërrasin ekspertë të jashtëm, specialistë të fushës. Eksperti i jashtëm e jep vlerësimin e tij me shkrim. Më pas, bazuar në këtë ekspertizë, Këshilli i Etikës merr vendim duke votuar.
7. Aplikantit duhet t'i jepet mundësia të dëgjohet nga KE, para se të merret vendimi. Seanca dëgjimore mund të refuzohet nëse Këshilli i Etikës është njëzëri i mendimit se një seancë nuk është e nevojshme.
8. Rezultati i vendimit të KE do t'i komunikohet aplikuesit me shkrim. Vlerësimet duhet të jenë të justifikuara. Secili anëtar mund të shprehë mendimin e tij kundërshtues në një votë të veçantë, e cila i bashkëngjitet vendimit.
9. Këshilli i Etikës mund të kërkojë dokumente shtesë, informacion ose sqarime nga aplikuesi gjithashtu, në përgatitje për vendimin e tij.
10. Vendimi i Këshillit të Etikës është i vlefshëm vetëm për aplikimin e paraqitur.
11. Këshilli i Etikës kryen vlerësimin e tij sipas procedurave dhe kritereve standarde shkencore të njohura.
12. Këshilli miraton ose refuzon projektin e kërkimit. Këshilli mund të kërkojë korrigjime ose modifikime të protokollit dhe formularit të dhënies së pëlqimit. Mund t'i kërkojë studiuesit të

paraqitet para tij për t'iu përgjigjur pyetjeve të tij. Ai duhet të presë studiuesin, që kërkon të dëgjohet.

13. Një projekt kërkimi që miratohet, me kusht kryerjen e modifikimeve, korigjimeve apo saktësimeve, mund të fillohet nga studiuesi vetëm atëherë, pasi Këshilli të ketë dhënë miratimin përfundimtar, pas plotësimit të këtyre kërkesave.

## Neni 22


### Vendimi mbi “Konstatimet dhe rekomandimet”

1. Këshilli i Etikës, si organ kolegjal i UMT-së, në çdo rast shprehet me vendim.
2. Si rregull, vendimi për “Konstatimet dhe rekomandimet” merret me shumicën e votave të anëtarëve, që marrin pjesë në mbledhje, por jo më pak se 3 (tri) vota, në të cilin duhen përcaktuar saktë:
  - gjeneralitetet e personit,
  - lloji i masës së propozuar,
  - kohëzgjatja e masës (afatet e shuarjes) sipas Rregullores së UMT-së;
  - arsyetimi përkatës.

## Neni 23

### Propozimi, emërimi dhe përfundimi i parakohshëm i funksionit të Këshillit të Etikës

1. Propozimi, emërimi dhe përfundimi i funksionit të Këshillit të Etikës bëhet sipas Ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe Statutit të UMT-së.
2. Mbarimi i parakohshëm i mandatit të Kryetarit dhe anëtarëve të KE-së:
  - a) Kur ndërpret marrëdhëniet e punës me UMT-në;
  - b) Për shkelje të rënda të ligjit;
  - c) Kur mungon pa arsye në 6 (gjashtë) mbledhje radhazi të KE-së;
  - d) Kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
  - e) Kur jep dorëheqjen;
  - f) Në kushtet e pamundësisë për të kryer detyrën;
  - g) Kur ndërron jetë.



**Neni 24**  
**Propozimet për ndryshimin e rregullores**

Këshilli i Etikës mund të bëjë propozime konkrete për rekomandime, mendime, përmirësime dhe ndryshimin e rregullores së funksionimit të tij në harmoni me legjislacionin në fuqi, duke ia përcjellë ato Senatit Akademik të UMT-së, për miratimin përfundimtar.

**Neni 25**  
**Forma e pagesës**

Trajtimi financiar për Kryetarin dhe anëtarët e Këshillit të Etikës dhe ekspertëve të ftuar, bëhet në përputhje për legjislacionin për organet kolegjiale dhe vendimmarrjen e Bordit të Administrimit të UMT-së.

**Neni 26**  
**Të drejtën e Interpretimit**

Të drejtën e interpretimit të kësaj rregulloreje e ka vetëm Senati Akademik i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

**Neni 27**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**

**PROF. DR. ARBEN GJATA**